



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

BULETINI

I REFERATEVE TË KANDIDATËVE TË PARAQITUR NË
KONKURSIN Nr. 01-236 TË DATËS 01.08.2016
PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

1. Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënës për lëndët: Metodatat e transmetimit, Metodatat e hulumtimit, Teknologjia TCP/IP, Inxhinjeringu softuerik dhe menaxhimi i projekteve, Metodatat kërkimore, Teknologjia e avancuar IP-ve dhe rrjeteve.

Kandidatët:

- 1. Prof.Ass.Dr. Malush Mjaku;**
- 2. Dr.sc. Muhamet Avdyli;**
- 3. Shkelzen S. Nuza, PhD Candidate;**

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Prizren



RAPORTI I KOMISIONIT RECENSUES

PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

Bazuar në Vendimin e Senatit të UPZ-së Nr. 285, të datës 30.09.2016 është emëruar komisioni recensues në përbërje:

1. Prof. Dr. Fehmi Krasniqi - Kryetar
2. Prof. Asoc. Dr. Ahmet Shala - Anëtar
3. Prof. Asoc. Dr. Aleksander Biberaj – Anëtar

për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët:

Metodat e transmetimit; Metodat e hulumtimit; Teknologjia TCP/IP; Inxhinieringu softuerik dhe Menaxhimi i projekteve; Metodat kërkimore; Teknologjia e avancuar IP-ve dhe rrjeteve.

Sipas konkursit me Nr. prot. 01-236 datë 01.08.2016.

Kandidatët që kanë aplikuar:

1. Prof. Ass. Dr. Malush Mjaku
2. Dr. sc. Muhamet Avdyli
3. Shkelzen S. Nuza, PhD Candidate

Ky raport shkruhet për titullin akademik: **Profesor Asocuar (Prof. Asoc.)**

TË DHËNAT PËR KANDIDATIN NR. 1

Emri dhe mbiemri: **Malush Mjaku**

Datëlindja dhe vendlindja: 20.02.1960 Sllatinë e Poshtme

Grada shkencore: **Doktor i Shkencave Teknike**, 2011, në Universitetin Kiril dhe Metodij, Shkup, Maqedoni. Nostrifikimi/Barasvlera nga KShNj/MASHT-ti nr. 6/548

Titujt akademikë: Profesor asistent në Universitetin “Ukshin Hoti” të Prizrenit, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.

Viti kur është fituar titulli aktual: 2012

Departamenti/Fakulteti: FSHK – TIT dhe DS

Pozita në UPZ: Prorektor për mësim, çështje studentore dhe kërkim shkencor

Kandidati i plotëson kriteret e Statutit të UPZ-së, Neni 172, të pikës 1.1.

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor për kandidatin

Tabela 1.

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Prej fillimit të karrierës	Gjatë 4 vjetëve të fundit
Numri i publikimeve në revistat me recension ndërkombëtar si autor kryesor ose korrespondent.	2	2
Numri i publikimeve në revistat, simpoziume, konferenca të nivelit rajonal si autor kryesor ose korrespondent.	10	3

Të dhënat për punimet

a) Punime me recension ndërkombëtar

1. **M. Mjaku, F. Krasniqi, Rr. Maksuti, D. Elezi:** Mathematical model and statistical analysis of the elongation of the steel J55 API 5CT before and after the development of the pipes, The 19th International DAAAM Symposium, Trnava, Slovakia 22-25 October 2008.

Punim ndërkombëtar i indeksuar në databazën SCOPUS

2. **MJAKU, Malush; KRASNIQI, Fehmi; BYTYÇI, Bajrush & OSMANI, Hysni:** Mathematical model and statistical analysis of the tensile strength (Rm) of the steel quality J55 API 5CT before and after the forming of the pipes, 6th Research/Expert Conference with International Participation Quality 2009, 04-07 June 2009, Neum, B&H.

Punim i nivelit ndërkombëtar, Simpozium ndërkombëtare

<http://www.quality.unze.ba/zbornici/QUALITY%202009/065-Q09-050.pdf>

3. **Mjaku Malush, Kozinakov Dimitri, Krasniqi Fehmi, Elezi Dervish:** Mathematical Model and Statistical Analysis of the Residual Stresses (σ residual) in the Cross Section Area of Steel Quality Pipes J55 API 5CT. 7th Research/Expert Conference with International Participations "Quality 2011" Neum, B&H, June 01- 04. 2011.

Punim i nivelit ndërkombëtar, Simpozium ndërkombëtare

<http://www.quality.unze.ba/zbornici/QUALITY%202011/089-Q11-035.pdf>

4. **Dimitri Kozinakov, Filip Zdraveski, Malush Mjaku:** Investigation of residual stresses in high frequency longitudinal welded pipes, Slovakia December 2012.

Journal ICTIC i indeksuar në databazën Index Copernicus:

http://journals.indexcopernicus.com/ICTIC,+Information+a,p24783017,3.html?utm_source=SARE&utm_medium=email&utm_campaign=ICI+Journals+Master+List+2014
Së shpejti edhe në SCOPUS <http://www.arsa-conf.com/abstracting-indexing/>

b) Punime shkencore me recension të nivelit rajonal

1. **M. Mjaku, B. Bytyçi, H. Osmani, F. Idrizi:** Përpunimi matematiko-statistikor i rezultateve të matjeve të fortësisë HV30 të çelikut J55 API 5CT para dhe pas formimit të gypit me tegel drejtvizor. Simpoziumi shkencor: Materialet dhe përdorimi i tyre, prej dates 19-21.11.2003. Prishtinë.
2. **M. Mjaku, B. Bytyçi, H. Osmani:** Modeli matematikor dhe përpunimi matematiko-statistikor i matjeve të qëndrueshmërisë në tërheqje (Rm) të çelikut J55 API 5CT para dhe pas formimit të gypit me tegel drejtvizor, Simpoziumi shkencor: Gjendja dhe perspektiva e inxhinierisë mekanike, mbajtur prej 20-21.05.2004 Prishtinë.
3. **M. Mjaku, B. Bytyçi, H. Osmani:** Modeli matematikor dhe përpunimi matematiko-statistikor i matjeve të kufirit të rrjedhshmërisë (ReH) të çelikut J55 API 5CT para dhe pas formimit të gypit me tegel drejtvizor, Simpoziumi shkencor: Gjendja dhe perspektiva e inxhinierisë mekanike, mbajtur prej 20-21.05.2004 Prishtinë.
4. **M. Mjaku, S. Shkodra, F. Krasniqi:** Modeli matematikor dhe përpunimi matematiko-statistikor i matjeve të sforcimit të çelikut X52 API 5LS, gjatë provave të gypave me tegel spiral me shtypje hidrostetike deri në shkatërrim, Simpoziumi i katërt ndërkombëtarë, Materialet dhe përdorimi i tyre prej 28-29.10.2004, Vlorë.
5. **Rr. Maksuti, H. Mehmeti, B. Bytyçi, M. Mjaku:** Përpunimi termik lokal i gypave të salduar me tegel drejtvizor, Simpoziumi i VI-të Ndërkombëtar "Materialet dhe përdorimi i tyre", Tiranë, 24-25 Nëntor, 2006.

6. **M. Mjaku, R. Maksuti & D. Elezi:** Përgjegjësia e sigurimit të cilësisë së tubave sipas kërkesave të standardit ISO 9002, Simpoziumi i VI-të Ndërkombëtar “Materialet dhe përdorimi i tyre”, Tiranë, 24-25 Nëntor, 2006.
7. **M. Mjaku, F. Krasniqi, Rr. Maksuti, D. Elezi:** Mathematical model and statistical analysis of the elongation(A2) of the steel J55 API 5CT before and after the development of the pipes, TMT, Istanbul, Turkey, 26-30 August 2008.
8. **KRASNIQI, Fehmi; MJAKU, Malush:** Mathematical model of the experiment with one factor a tensile strength (Rm) of the steel quality J55 API 5CT before and after the forming of the pipes, 13th International Research/Expert Conference”Trends in the Development of Machinery and Associated Technology”, TMT 2009, Hammamet, Tunisia, 16-21 October 2009.
9. **KRASNIQI, Fehmi; MJAKU, Malush-ASHAK: MODELI MATEMATIKOR DHE ANALIZA STATISTIKORE E EKSPERIMENTIT ME NJË FAKTOR TË KUFIRIT TË RRJEDHSHMËRISË (R_{EH}) TE GYPAT ME TEGEL DREJTVIZOR, AKADEMIJA E SHKECAVE DHE E ARTEVE TË KOSOVËS, SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS KËRKIME 17, PRISHTINË 2009.**
10. **Rrahim Maksuti, Hamit Mehmeti, Malush Mjaku:** Vendorsja e bashkëpunimit universiteti-industria, nevojë imediate për zhvillim tekniko teknologjik, “Java e shkencës”, MASHT, 01-05.03.2010, Prishtinë.
11. **Rrahim Maksuti, Hamit Mehmeti, Mursel Rama, Malush Mjaku:** Anizotropia e vetive mekanike e çelikut të petëzuar në të nxehtë, , “Java e shkencës”, MASHT, 01-05.03.2012, Prishtinë.
12. **Rrahim Maksuti, Hamit Mehmeti, Mursel Rama, Malush Mjaku:** Përdorimi industrial i saldimit dhe proceseve të ngjajshme me saldimit, “Java e shkencës”, MASHT, 14,15,16,17 dhe 18 Maj 2013, Prishtinë.
13. **Naim BAFTIU , Sabedin KRRABAJ, Malush Mjaku:** Shërbimet elektronike të së ardhmës për e-qeverisjen në Republikën e Kosovës , Takimi i Njëmbëdhjetë vjetor ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca Tiranë, 01 - 03 shtator 2016.

Kandidati i plotëson kriteret e Statutit të UPZ-së, Neni 172, të pikës 1.2.

2. Përvoja në mësimdhënie universitare dhe mobiliteti

Mbështetur në biografinë e kandidatit, i cili ka dëshmuar se ka provojë të konsiderueshme në mësimdhënie universitare. Kandidati nga provoja e tij profesionale ka dëshmuar se ka qenë mjaft profesional dhe udhëheqës i suksesshëm në fushën e tij. Ai ka publikuar një numër të konsideruar të punimeve në konferenca, revista shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Ka punuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Departamentin e Arsimit të Lartë, si u.d. Drejtor i Departamentit të Arsimit të Lartë. Pastaj, ka qenë themelues i **Departamentit të Shkencës dhe Teknologjisë**; u.d. Drejtor i **Departamentit dhe Shef i Divizionit të Teknologjisë**. Ka qenë anëtarë i Këshillit Drejtues të UPZ-së. Aktualisht është

profesor asistent me marrëdhënie të rregullt pune në UPZ, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Prorektor për Mësim, Çështje Studentore dhe Kërkim Shkencorë në UPZ. Ka të realizuara dhe të pranuar një varg certifikatash dhe diplomash brenda dhe jashtë vendit, si: a) Human Resource-Motivation; b) Organisation; c) Human Resource- Personalmanagement; d) Projektmanagemen, Wirtschaftsforderungsinstitut (WFI), Wien, (17.10.2005 - 17.03.2006); Leadership, National Albanian American Council (1996), Maj-July, 2007. Certifikatë, Udhëheqja, Motivimi dhe Delegimi, Instituti i Kosovë për Administratë Publike, 29-31 Maj 2006. Certifikatë, Strategic Planning, Management & Development Associates, Durrës, Albania 18 October 2007.

Ka punuar në Fabrikën e Tubave në Ferizaj dhe njëherazi për disa vite në pozitën e Drejtorit të kontrollës dhe kualitetit në nivel qendrorë të IMK-së.

Përvoja e tij e gjatë në fusha të ndryshme e ka bërë kandidatin Z.Mjakun të ndërtojë aftësi të mira në mësimdhënie dhe në koordinimi të arsyeshëm me marrëdhënia njerëzit, aspektet financiare dhe buxhetore të një kompanie, aspektet menaxhuese dhe organizative, menaxhimin e projekteve të ndryshme, menaxhimin e kualitetit etj.

Në saje të punës kërkimore-shkencore, në një varg revistash dhe konferencash shkencore si dhe në punimin e disertacionit të doktoraturës, kandidati Z.Malush Mjaku për verifikimin e rezultateve gjatë punës kërkimore-shkencore ka aplikuar softuer aplikativ, si p.sh Design Expert Software, si dhe paket programin ANSYS për verifikimin e parametrave kompleks-teknik. Kjo provojë shkencore dhe profesionale ia ka mundësuar kandidatin që të jetë mësimdhënës i thirrur për lëndët: Metodot e transmetimit; Metodot e hulumtimit; Teknologjia TCP/IP; Inxhinjeringu softuerik dhe menaxhimi i projekteve; Metodot kërkimore; Teknologjia e avancuar IP-ve dhe rrjeteve. Shumicën nga lëndët në fjalë, kandidati i ka ligjëruara në disa universitete publike dhe private dhe për katër vite me radhë i ka ligjëruar në UPZ, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.

Gjatë përvojës së tij profesionale dhe studimore kam kaluar nëpër situata të ndryshme dhe me sfida të fushave apo disiplinave të ndryshme, përgjatë këtij rrugëtimi mund të përmbledhim se ka konfirmuar disa aftësi të mira personale, të cilat do i paraqes më poshtë: Aftësi udhëheqëse apo leadership; Aftësi menaxhuese duke përfshirë të gjitha komponentët e tij; Guxim për

vendimmarrje në situata të ndryshme; Pragmatik në qasje ndaj situatave të ndryshme; Fleksibilitet në punë ekipore; Aftësi për të punuar brenda afateve dhe kufizimeve të caktuara; I hapur ndaj ideve të reja por këmbëngulës në mënyrën e tij të arsyetuar. Aftësi për t'i dhënë zgjidhje problemeve në situata të ndryshme.

Kandidati ka disa vite përvojë punë në universitete publike dhe private, themelues i disa departamenteve profesionale, të cilat janë dëshmuar për pozitivitet, dhe kandidati ka dëshmuar kreativitet të plotë. Kriteret e Statutit të UPZ-së, Neni 172, pika 1.4 dhe 1.5, kandidati i plotëson.

TË DHËNAT PËR KANDIDATIN NR. 2

Emri dhe mbiemri: **Muhamet Avdyli**

Datëlindja dhe vendlindja: 10.08.1959, Tërm, Ferizaj

Grada shkencore: **Doktor në Shkenca ekonomike, profili Menaxhimi i sistemeve të informacionit** 2016, në Universitetin Europian të Tiranës, Shqipëri.

Nostrifikimi/Barasvlera nga KShNj/MASHT-ti mungon/s'ka, ka dorëzuar vetëm dëshminë e aplikimit.

Titujt akademikë: Ligjërues në Universitetin “Ukshin Hoti” të Prizrenit, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.

Viti kur është fituar titulli aktual: 2011-2015

Departamenti/Fakulteti: FShK

Kandidati nuk i plotëson kriteret e Statutit të UPZ-së, Neni 172, të pikës 1.1.

TË DHËNAT PËR KANDIDATIN NR. 3

Emri dhe mbiemri: **Shkelzen S. Nuza**

Datëlindja dhe vendlindja: 29.12.1983 Smolicë, Gjakovë

Grada shkencore: **Master i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike, UP/FIEK 2012 / PhD Candidate**, 2013, në Dokuz Eylul University, Izmir, Turqi

Titujt akademikë: Asistent mësimorë në Universitetin “Ukshin Hoti” të Prizrenit, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.

Viti kur është fituar titulli aktual: 2016


Kandidati nuk i plotëson kriteret e Statutit të UPZ-së, Neni 172, të pikës 1.1.

PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Mbështetur në legjisllacionit e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë dhe mbështetur në Statutin e UPZ dhe mbështetur në CV të kandidatëve, Komisioni recensues pasi ka analizuar dhe vlerësuar materialet e dorëzuara nga kandidatët propozon zgjedhjen e kandidati **Prof. Ass. Dr. Malush Mjaku** i cili i ka plotësuar të gjitha kushtet juridike dhe profesionale për t'u propozuar për thirrjen **Profesor i Asocuar.** në Universitetin "Ukshin Hoti" të Prizrenit, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike për lëndët: **Metodat e transmetimit; Metodat e hulumtimit; Teknologjia TCP/IP; Inxhinieringu softuerik dhe menaxhimi i projekteve; Metodat kërkimore; Teknologjia e avancuar IP-ve dhe rrjeteve.**

Komisioni recensues:

1. Prof. Dr. Fehmi Krasniqi - Kryetar



2. Prof. Asoc. Dr. Ahmet Shala – Anëtar



3. Prof. Asoc. Dr. Aleksander Biberaj – Anëtar



Prizren, Shtator /2016